

Buletini Informativ - ATTSO

Janar - Qershor 2018



INFORMACIONE TË
NDRYSHME DHE AKTUALITETE
MBI DHOMËN

36
Faqe

KOMPANIA E PARË MË E MADHE E TELEKOMUNIKACIONEVE NË SHQIPËRI



INTERNET



MOBILE



IPTV



FIKS

105 vite eksperiencë

I vetmi që ofron 4 shërbime

Sjellim internet në më shumë
se 650,000 shtëpi

Sjellim fibrën optike
në çdo ambjent

Me kapacitetin më të madh
të internetit, rreth 130 Gb/s

I pari e i vetmi ofrues i
shërbimeve të menaxhuara

Ofruesi i vetëm i shërbimit
Wi-Fi të menaxhuar





Dhoma e Tregtisë
Dhe Industrisë
Shqipëri – Turqi

Buletin Informativ
ATTSO

Gjuha e Publikimit:
Shqip
Lloji i Publikimit:
Biznes

Dizenjim:
Alaattin Ozde

Shtypur në Shqipëri:
Bosfor Design &
Publicity

Përgatiti:
Dhoma e Tregtisë
dhe Industrisë
Shqipëri- Turqi

A: MakAlbania Hotel
and Tower, Kati II.,
Tiranë

T: +355 42 200 700

F: +355 42 200 701

<http://attso.al/>

E –Mail:
info@attso.al

Copyright:
ATTSO, 2018

PËRMBAJTJA

04 MESAZHI I AMBASADORIT & MESAZHI I
KRYETARIT TË BORDIT DREJTUES

06 MARRËDHËNIET TREGTARE MIDIS SHQIPËRISË
DHE TURQISË

08 SFIDAT E TREGUT TË TELEKOMUNIKACIONIT

10 TURIZMI SHËNDETËSOR NË TURQI

12 PROFILI I BKT

14 AYEN ENERGJI SH.A

16 INDUSTRIA E ÇELIKUT NË SHTETET E
BASHKUARA TË AMERIKËS

18 INSTITUTI YUNUS EMRE NË TIRANË

20 GRUPI AKSOY

22 AKTUALITETE NGA DHOMA

30 PROFILI I FMT GROUP

32 BOGA & ASSOCIATES

33 GJINISHI TAX CONSULTING

34 ANËTARËT E DHOMËS

MESAZHI I AMBASADORIT



SH. T. Z. M. AHMET YÖRÜK

AMBASADORI I TURQISË NË SHQIPËRI
KRYETAR NDERI I ATTSO

Të dashur sipërmarrës,

Sikurse dihet, falë strategjive të duhura në aspektin makroekonomik gjatë 15 viteve të fundit, politikave të kujdesshme fiskale dhe reformave strukturore, ekonomia e Turqisë ka arritur të integrohet në botën e globalizuar dhe bazuar në paritetin e fuqisë blerëse është ekonomia e 13-të më e madhe në botë.

Ndërkohë që vendi ynë arriti të kthehej në një vend tërheqës për investimet e huaja direkte, gjatë këtij procesi, shumë kompani turke kanë shtrirë investimet e tyre jashtë vendit.

Sot është e mundur që të gjejmë kompani turke të cilat operojnë në fushën e tregtisë dhe janë të pranishme edhe në skajet më të largëta të botës. Në Shqipëri kemi kompani që kanë arritur suksese të rëndësishme, ku secila prej tyre mund të jetë objekt i një studimi të veçantë akademik.

Në fund të vitit 2017 vëllimi tregtar midis dy vendeve tona arriti në vlerën 480 milionë dollarë, duke renditur Turqinë si partnerin e 5-të më të rëndësishëm të Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, Turqia cilësohet si një ndër vendet me investim më të madh në Shqipëri. Në kompanitë turke që kanë investuar në Shqipëri në sektorë me rëndësi strategjike si energjetika, sistemi bankar, telekomunikacioni, logjistika, minierat, infrastruktura, ndërtimi, janë të punësuar rreth 10.000 vëllezër tanë shqiptarë.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri – Turqi, e cila është themeluar nga ju të nderuar anëtarë, është e vendosur për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët që do t'u shërbejë interesave të të dy vendeve. Duke zgjeruar gamën e pranisë ekonomike dhe tregtare në Shqipëri, ATTSO, për periudhën në vazhdim synon të rrisë edhe kontributin material për mirëqenien dhe zhvillimin e vendit, si dhe për procesin e reformave.

Në këtë kuadër, ftojme kompanitë tuaja të bëhen pjesë e ATTSO's, e cila falë punës së saj po kthehet në një institucion të rëndësishëm biznesi. Prania juaj do të kontribuojë në forcimin e mëtejshëm të lidhjeve vëllazërore ndërmjet dy vendeve tona mike që datojnë që në shekullin e 14-të.

Me këto ndjenja dhe mendime, urojmë që viti 2018 të jetë një vit sa më i suksesshëm për kompaninë tuaj dhe ju përcjellim urimet më të përzemërta.

MESAZHI I KRYETARIT TË BORDIT DREJTUES

Të dashur tregtarë dhe industrialistë,

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri - Turqi është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në Dhjetor të vitit 2014 me iniciativën e dhjetë kompanive më të mëdha turke që operojnë në Shqipëri dhe nën kujdesin e veçantë të Ambasadës Turke në Tiranë.

Si Dhomë, ndihemi krenarë për kontributin tonë në ekonominë shqiptare duke bërë të mundur punësimin e 10,000 personave. Detyra jonë prioritare është që të çojmë akoma edhe më tej marrëdhëniet tregtare dhe social-kulturore midis dy vendeve tona, dhe duke u fokusuar tek anëtarët tanë të shndrohemi në një Dhomë bashkëkohore dhe proaktive.

Ndërsa jemi duke u rritur çdo vit e më shumë, tashmë Dhoma jonë numëron më tepër se 50 anëtarë që përfaqësojnë biznesin e madh, të mesëm dhe të vogël dhe që operojnë në sektorë e fusha të ndryshme të ekonomisë.

Unë personalisht, besoj në fuqinë e kompanive që mbledhen rreth të njëjtit qëllim të përbashkët për të krijuar një ambient më stimulues pune dhe për të siguruar vazhdimësinë e saj. Për këtë arsye, gjej rastin të ftoj të gjitha kompanitë në Shqipëri të marrin pjesë në takimet e biznesit që organizohen nga Dhoma jonë dhe të përfitojnë nga shërbimet që ajo ofron. Shpresoj që takimet e biznesit ndihmojnë në forcimin e komunikimit midis anëtarëve tanë si dhe i ndihmon ata të lidhin marrëveshje bashkëpunimi afatgjata.

Kompanitë tona anëtare mund të marrin pjesë në paignaire dhe misionet biznesi të ndryshme që organizohen me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Turqisë. Gjithashtu, ne dëshirojmë që anëtarët tanë të përfitojnë nga bashkëpunimet që ne kemi me Dhomat e tjera bilaterale dhe lokale, si dhe nga programi "Benefit" i dizenuar posaçërisht për anëtarët tanë ku secili prej tyre ofron zbritje në çmim për produktet dhe shërbimet që ata ofrojnë. Dy popujt tanë kanë jetuar prej shekujsh me njëri tjetrin. Le të mbledhemi nën çatinë e ATTSO si kompanitë shqiptare ashtu edhe ato turke, në mënyrë që të jemi më të fortë së bashku.



SEYHAN PENCABLILIGIL

KRYETARI I BORDIT DREJTUES - ATTSO



MARRËDHËNIET TREGTARE

MIDIS SHQIPËRISË DHE TURQISË

Shkëmbimet tregtare midis Shqipërisë dhe Turqisë edhe pse janë rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë pesë viteve të fundit, vazhdojnë të mbeten poshtë potencialit ekzistues. Duke pasur parasysh afërsinë gjeografike dhe diversifikimin e veprimtarive ekonomike të të dy vendeve tona, unë besoj se në një periudhë afatshkurtër, vëllimi tregtar mund të dyfishohet. Marrëveshja e Tregtisë së Lirë që ekziston midis dy vendeve që prej vitit 2008, është një mjet i rëndësishëm në nxitjen e tregtisë dypalëshe.

Duke u bazuar në të dhënat statistikore të INSTAT-it, shkëmbimet tregtare midis Shqipërisë dhe Turqisë në vitin 2017 u llogaritën në 52.9 miliardë lekë, me një rritje 9.1% krahasuar me vitin paraardhës. Eksportet e Turqisë kapën vlerën e 50.8 miliardë lekëve, duke u rritur me 11%, ndërsa eksportet e Shqipërisë pësuan një ulje prej 27% duke arritur vlerën 2.9 miliardë lekë. Shkaktari kryesor i rënies së eksportit kundrejt Turqisë ka qënë ulja e çmimit të mineraleve dhe hekurit.

Shkëmbimet tregtare (miliardë lekë)

	2013	2014	2015	2016	2017
Importi i Shqipërisë nga Turqia	32.9	39.1	43.7	45.6	50.8
Eksporti i Shqipërisë drejt Turqisë	9.2	10.1	6.9	2.9	2.1
Vëllimi	42.0	49.2	50.6	48.5	52.9

Burimi : INSTAT



Gjatë vitit 2017 Turqia ishte partneri i dytë më i madh importues dhe partneri i nëntë më i madh eksportues i Shqipërisë. Eksportet e Turqisë drejt Shqipërisë dominohen kryesisht nga grupi tekstile dhe këpucë (13.1%), pajisje elektrike dhe pjesët e tyre (6.8%), makineri (6.7%), produkte të drurit dhe letra (5.2%), produktet e hekurit dhe çelikut (4.5%) dhe plastika (4.5%).

Ndërsa përsa i përket grupmallrave që janë eksportuar më së shumti në Turqi janë kryesisht



materialet e ndërtimit duke përfshirë hekurin dhe çelikun (31.3%), ushqime dhe pije (18.3%), pajisje elektrike dhe pjesë makinerie (12.1%), kimikate dhe materiale plastike (11.8%) dhe minerale dhe lëndë djegëse (11.4%).

SITUATA E DERITANISHME

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri – Turqi (ATTSO) synon të forcojë tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve tona duke organizuar misionet tregtare në Turqi, si dhe të lehtësojë zgjidhjen e problemeve që anëtarët e saj hasin në Shqipëri. Gjithashtu dua të theksoj faktin se mbledhja e Komitetit të Përbashkët Ekonomik dhe Teknik midis Shqipërisë dhe Turqisë i cili është krijuar bazuar në marrëveshjen e nënshkruar në vitin 2001 dhe ka si qëllim kryesor rritjen e bashkëpunimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, planifikohet të realizohet gjatë vitit 2018. Shpresojmë që ky takim do të luaj një rol të rëndësishëm në rritjen e investimeve dhe shkëmbimeve bilaterale midis dy vendeve tona mike.

Z. Halis KAYA
Atasheu Tregtar

SFIDAT E TREGUT TË TELEKOMUNIKACIONIT

Intervistë me Drejtorin Ekzekutiv të ALBtelecom, z. Tahsin Yilmaz, dhënë për Revistën Monitor.

Konkurrenca e lartë në segmentin e telefonisë së lëvizshme dhe ndryshimi i sjelljes konsumatore në drejtim të përdorimit të telefonave fiks e kanë bërë mjaft sfidues tregun e telekomunikacioneve në vend. ALBtelecom, që

vepron në të dy fushat, është përpjekur që këto sfida t'i kthejë në mundësi. Drejtori ekzekutiv i ALBtelecom që prej nëntorit 2016, Tahsin Yilmaz, i cili ka një karrierë të gjatë në fushën e telekomunikacioneve, pohon se për shkak të rritjes së lartë të përdorimit të të dhënave, infrastruktura e linjës fikse merr një vlerë të pakrahasueshme përballë kërkesës në rritje për sasi dhe cilësi të të dhënave përmes celularit apo pajisjeve të tjera elektronike. Ai thotë se kompania ka arritur të zgjerojë bazën e pajtimtarëve të telekomunikacioneve fikse në sajë të internetit me brez të gjerë (broadband) dhe të ofertave në IPTV.

Tregu i telefonisë fikse është në një fazë maturimi prej vitesh për shkak të zhvillimit të teknologjisë. Si po përshtateni ndaj këtyre zhvillimeve?

Ne jetojmë tashmë në një epokë dinamike, me një ndërveprim të lartë në komunikim, ku rritja e përdorimit të të dhënave dhe kontenti që qarkullon po rriten me ritme të paimagjinueshme. Për rrjedhojë, infrastruktura e linjës fikse merr një vlerë të pakrahasueshme përballë kërkesës në rritje për sasi dhe cilësi të të dhënave përmes celularit apo pajisjeve të tjera elektronike. Këto zhvillime i japin ALBtelecom avantazh konkurrues në treg për t'iu përgjigjur këtyre sfidave.

ALBtelecom ka në zotërim rrjetin themelor të fibrave optike në të gjithë vendin. Aktualisht janë në shfrytëzim mbi 2,000 km fibra optike që shtrihen në të gjitha qytetet e vendit, duke i lidhur ato në të paktën dy rrugë/alternativa të ndryshme, që mundësojnë ofrimin e shërbimeve tek abonenti me disponueshmëri në nivelin 99.9%.

Nëpërmjet këtij rrjeti bëhet e mundur edhe lidhja tokësore ndërkombëtare me të gjitha vendet fqinje si Greqia, Maqedonia, Kosova e Mali i Zi, si dhe me Italinë, me anë të sistemit me fibra optike nëndetare, e cila është dhe e vetmja lidhje nëndetare e Shqipërisë me Italinë.



Drejtor Ekzekutiv i ALBtelecom
Z. Tahsin Yilmaz

Ky sistem fibrash optike siguron cilësinë më të lartë të transmetimit, si dhe kapacitetet e nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm, duke ofruar shërbim bashkëkohor dhe të pandërprerë në çdo kohë.

ALBtelecom, bazuar në këtë sistem fibrash, realizon lidhjen e rreth 80% të të gjithë përdoruesve të internetit në Shqipëri me rrjetin ndërkombëtar, në mënyrë të drejtpërdrejtë për abonentët tanë, si dhe për operatorë të tjerë, që na drejtohen ne për të blerë qasje në internet me shumicë.

ALBtelecom gjithashtu ka një rrjet të gjerë lokal të shpërndarë në 74 qendrat kryesore (qytete) të Shqipërisë. Kapaciteti i linjave fizike mbështetet në mënyrë mjaft eficiente në nyjet aktive të lidhura me rrjetin e fibrave optike. Që do të thotë se me rrjetin ALBtelecom arrijmë pothuajse në të gjithë familjet në vend, një investim ky i realizuar me qëllim ofrimin e shërbimeve inovative për çdo shtëpi. Aktualisht, mund të përmendim se 67% e klientëve tanë të shërbimit fiks janë përdorues të internetit me brez të gjerë (broadband) dhe tendenca është në rritje të vazhdueshme.

Një avantazh tjetër i ALBtelecom, i mundësuar nga posedimi i rrjetit të fibrave optike, është edhe lidhja e stacioneve të telefonisë së lëvizshme (mobile) 3G&4G me fibrat optike (mbi 200 km fibër optike e destinuar për lidhjen e stacioneve të telefonisë së lëvizshme (mobile)). Një lidhje e tillë garanton kapacitet më të lartë, që përkthehet direkt në shërbim më cilësor për abonentët tanë.

Cilat janë planet tuaja për të ardhmen në drejtim të telefonisë fikse, mobile, internetit dhe shërbimeve të tjera?

ALBtelecom po kryen disa studime për teknologjitë e reja,

të cilat edhe operatorë të mëdhenj në Europë, nuk kanë filluar t'i zhvillojnë në masë, bazuar tek avantazhi që krijon kapaciteti i rrjetit tonë fiks.

Duke konsideruar kërkesat në rritje të klientëve, si dhe shërbimet e reja, të cilat së shpejti do të jenë më të shumta në numër dhe kërkojnë kapacitete/shpejtësi më të lartë transmetimi apo interneti, ALBtelecom po punon që brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, në rrjetin fiks të lançohet faza e parë e projektit FTTH (fibër optike në shtëpi) i mbështetur nga teknologjia GPON (rrjet pasiv me fibra optike të nivelit Gbps). Nëpërmjet këtij projekti do të ofrohet shërbim i internetit me shpejtësi shumë të lartë deri në 1Gbps (1024Mbit/s), jo vetëm për abonentët biznes, por edhe për ata familjarë. Ky projekt do të zbatohet pothuajse në të gjitha qytetet e Shqipërisë dhe në fazën e tij finale do të zëvendësojë rrjetin ekzistues NGN (rrjet i gjeneratës tjetër bazuar kryesisht mbi kabllot e bakrit), si dhe do të mundësojë lidhjen në të ardhmen e shumicës së stacioneve të antenave celulare 5G.

Pra me këtë projekt, ALBtelecom pas disa vjetësh do të ketë një rrjet fiks që mbështetet i gjithi te fibrat optike, deri tek abonenti fundor, por njëkohësisht edhe një rrjet të telefonisë së lëvizshme (mobile) që gjithashtu do të mbështetet më së shumti mbi kapacitetin e fibrave optike, duke ofruar shërbime të internetit me brez të gjerë (broadband) për çdokënd në çdo cep të vendit.

Shërbimet e integruara janë një tjetër fjalë kyçe në tregun e sotëm të telekomunikacionit.

Ne synojmë të lehtësojmë sa më shumë që të jetë e mundur përvojën konsumatore, duke ofruar mundësinë që konsumatorët të kenë të gjitha produktet që iu nevojiten nga telefoni celular, komunikimi fiks, interneti, IPTV, të gjithë nën të njëjtin ofrues shërbimi. Shërbimet e integruara na lejojnë gjithashtu që të jemi konkurrues dhe të sigurojmë ofertën më cilësore, por njëkohësisht



edhe më ekonomike.

Si e prisni ecurinë e tregut të telekomunikacioneve në përgjithësi në Shqipëri?

Me ritmin e shpejtë të zhvillimeve të teknologjisë në botë, duke filluar nga konsumimi gjithnjë e në rritje i kontetit, videove dhe aplikacioneve deri te sfidat që sjell Internet of Things (IoT – Interneti i Sendeve), fjala kyçe në fushën e telekomunikacionit mbetet shërbimi i transmetimit të të dhënave ose thënë ndryshe “shërbimet data”.

Në rastin e Shqipërisë, ka ende një rrugë të gjatë përpara lidhur me përdorimin e shërbimit data apo edhe depërtimin e telefonave apo pajisjeve të tjera smart. Ne presim në një të ardhme të afërt, që përdorimi i shërbimeve data të vazhdojë të rritet, si në rrjetin fiks dhe në atë celular. Për shërbimet e telekomunikacioneve të lëvizshme (përfshi edhe atë televiziv), do të maksimizojmë mbështetjen në infrastrukturën fikse të fibrës optike dhe në zgjerimin e saj. Për fat të mirë, ne jemi teknikisht dhe komercialisht të gatshëm për këtë të ardhme. Qëllimi ynë është që të sjellim teknologji dhe inovacion të fjalës së fundit në çdo shtëpi, te çdo shqiptar.

TURIZMI SHËNDETËSOR NË TURQI

Turizmi shëndetësor po shndërohet në një aktivitet të rëndësishëm ekonomik që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe rritjen e konkurrencës. Afërsia gjeografike e Turqisë me tregjet kryesore si dhe cilësia e lartë e shërbimeve mjekësore, e bëjnë këtë sektor një nga më të rëndësishmit në Turqi.

Edhe pse matja e vëllimit të këtij sektori përbën një sfidë të jashtëzakonshme për shkak të kornizës së papërcaktuar të turizmit mjekësor nga autoritetet shëndetësore botërore, të ardhurat globale të turizmit shëndetësor janë vlerësuar më shumë se 100 miliardë dollarë në vitin 2015. Në vitin 2022 kjo shifër mendohet të arrijë në 143 miliardë dollarë, me një rritje mesatare prej 15.7%. SHBA'ja, Gjermania, Tajlanda, India dhe Turqia janë 5 destinacionet më të preferuara të turizmit shëndetësor.

Sipas të dhënave të Ministrisë së



Shëndetësisë të Turqisë, në vend ofrojnë shërbime shëndetësore 1,514 poliklinika nga të cilat 70 janë spitale universitare, 560 janë spitale private ndërsa pjesa tjetër janë spitale publike. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në këto spitale është 593,178 nga të cilët 139.985 janë mjekë. Përveç spitaleve ekzistojnë 442 qendra të kirurgjisë robotike, onkologjisë mjekësore, njësi të mjekësisë nukleare si dhe qendra spitalore të tjera. 48 është numri i spitaleve të akredituar nga Komisioni i Përbashkët Ndërkombëtar (JCI - Joint Commission International) në Turqi, numër i cili është një nga më të lartët në botë.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, Turqia ka investuar sasi të konsiderueshme kapitali për rritjen e infrastrukturës teknologjike dhe të cilësisë së shërbimeve mjekësore duke rritur ndjeshëm konkurrueshmërinë në këtë sektor. Si rezultat i këtyre përpjekjeve dhe investimeve në sektorin e shëndetësisë, ka bërë që Turqia të pozicionohet në shtetet më të mira për turizmin shëndetësor.

Shtrirja gjeografike ndërkontinentale, infrastruktura e nevojshme në sektorin e shëndetësisë, disponueshmëria e fuqisë punëtore të kualifikuar si dhe numri i qendrave shëndetësore të cilat ofrojnë shërbime në përputhje me standardet ndërkombëtare, e kanë bërë Turqinë një nga shtetet lider në këtë sektor. Si pasojë, trajtimet shëndetësore në Turqi preferohen jo

vetëm nga vendet fqinje por edhe nga nga vendet e Azisë Qendrore, Lindjes së Mesme, Ballkanit dhe Kaukazisë.

Interesi primar duket se vjen kryesisht nga shtetet me të ardhura më të larta vjetore sesa Turqia. Pjesërisht, ata joshen nga çmimet e ulëta dhe konkurrese. Të dhënat tregojnë se më shumë se 140 nacionalitete kanë preferuar turizmin shëndetësor në Turqi. Nga vendet Europiane mund të spikatim gjermanët, britanikët dhe holandezët.

Njerëzit gjithashtu udhëtojnë nga Iraku, Rusia, Kuvajti, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe drejt Turqisë. Projekti i Turqisë në Afrikë i cili synon të rrisë biznesin, tregtinë dhe marrëdhëniet midis Turqisë dhe kontinentit afrikan gjithashtu luan një



rol të madh në promovimin e shërbimeve mjekësore turke ndaj kombësive afrikane.

Kategoritë më të prekura dhe trajtimet mjekësore më të preferuara në Turqi janë sëmundjet e syrit.

Edhe pse ka shumë trajtime disa janë më popullore se të tjerat në të cilat përfshihet kirurgjia e syrit, shërbimet dentare dhe transplantet e flokëve. 180 burimet natyrore me ujëra termale në Turqi tërheqin ata që duan të rigjallërojnë lëkurën dhe trajtojnë muskujt. Statistikat nxjerrin në pah se shumica e evropianëve udhëtojnë drejt Turqisë për trajtimet e sëmundjeve të syrit, ndërsa arabët për transplantin e flokëve. Klinikat në Turqi kryejnë rreth 200 operacione për transplantimin e flokëve çdo ditë.

Të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë së Turqisë tregojnë se numri i pacientëve të



huaj në vitin 2016 ka qenë 359,668 ndërsa në vitin 2015 kjo shifër ishte 392,950. 57% e pacientëve ndërkombëtarë kanë aplikuar në klinikat private dhe pjesa tjetër në klinikat publike. Gjermania, Azerbajxhani, Iraku, Libia dhe Siria janë vendet udhëheqës në turizmin mjekësor. Në vitin 2016, trajtimet mjekësore më të preferuara për pacientët ndërkombëtarë kanë qënë gjinekologjia, çrregullimet e syrit, mjekësia e brendshme, pediatria dhe otolaringologjia.

Shumë qendra rreth Turqisë ofrojnë gamën e plotë të trajtimeve mjekësore, por Stambolli ka rezultuar të jetë destinacioni më i lakmuar për turistët mjekësorë. Më pas janë spitalet private në zonën e Egjeut veçanërisht në Bodrum, Ankara, Izmir dhe Bursa.

Dr. Rubin Topi
Përfaqësues i Këshillit të Turizmit
Shëndetësor Turk në Shqipëri (THTC)

Profili i BKT

Rrënjët e Bankës Kombëtare Tregtare datojnë më 29 nëntor 1925 me krijimin e degës së parë në godinën historike në Durrës që përfaqëson edhe institucionin financiar shqiptar më të vjetër në vend. BKT, me emërtimin që ka sot, u themelua në janar të vitit 1993 nga bashkimi i Bankës Tregtare Shqiptare dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë. BKT u regjistrua si shoqëri aksionere në vitin 1997 dhe sot është Banka më e madhe dhe më e vjetër në Shqipëri. BKT përfundoi procesin e privatizimit në vitin 2000 dhe më 30 qershor 2009, Çalik Holding u bë aksioneri i vetëm i BKT. Duke pasur një strukturë të konsoliduar të kapitalit me avantazhe të gjera dinamike dhe konkurruese, BKT filloi një fazë të re të rritjes dhe suksesit të qëndrueshëm. Duke qenë banka më e vjetër dhe ofruesi i parë i shërbimeve financiare në vend, BKT ka eksperiencë të gjatë në vend, një kulturë solide korporate dhe një qasje më inovative për të mbështetur vizionin e saj. Me performancën e saj të qëndrueshme BKT vlerësohet me çmime prestigjioze të ndryshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke marrë vazhdimisht tre çmimet kryesore në industrinë bankare:

- "Banka më e mirë në Shqipëri" nga Euromoney për të gjashtë herë;

- "Banka më e mirë në Shqipëri" nga EMEA Finance për të shtatin vit radhazi;

- "Banka më e mirë në Shqipëri" nga The Banker për tetin vit;

Një vlerësim tjetër i rëndësishëm vjen nga JCR-Euroasia, një nga agjencitë më prestigjioze të vlerësimit në botë, rikonfirmon BKT-në me vlerësimin AAA (Alb) për të nëntin vit radhazi.

Duke ecur përpara me besim në rrugën e rritjes së qëndrueshme, BKT vazhdon të ofrojë produkte, shërbime për zgjidhje inovative me vlerë të shtuar për klientët e saj përmes një platforme shërbimesh me 94 degët e saj në Shqipëri dhe Kosovë. Kuptimi i nevojave të klientëve dhe transformimi dixhital i shërbimeve tona bankare e bën BKT-në të jetë shumë më afër klientëve të saj dhe të thellojë besimin dhe sigurinë e tyre. E fokusuar në përkushtimin e vazhdueshëm ndaj standardeve më të larta të përsosmërisë, BKT do të vazhdojë të dominojë tregun dhe të jetë kompania më fitimprurëse në Shqipëri.

Simboli i suksesit



BANKA
MË E MADHE,
MË E VJETËR
* DHE MË E MIRË
NË SHQIPËRI.

Partneri më i mirë i biznesit, me 67 degë në Shqipëri (27 degë në Kosovë) me një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh.



* EUROMONEY: 6 herë, The Banker: 8 herë, EMEA Finance: 7 herë radhazi, JCR Eurasia: 9 herë radhazi.

BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE



4 22 66 288 | www.bkt.com.al



AYEN ENERGJI SH.A

Ayen Energji A.S është krijuar nga Aydiner Construction A.S. në vitin 1990 me qëllim prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe tregtimin e energjisë elektrike. Kompania është themeluar në kuadër të Aydiner Construction Group.

Kompania jonë ka qenë një ndër kompanitë private më të vjetra të energjisë në Turqi dhe e hapur për aksionerët publik që prej vitit 2000 në bursën e Stambollit.

Kompania ka investuar kryesisht në fushën e energjisë hidrike dhe energjisë së erës. Projektet, duke përfshirë edhe përgatitjen e raporteve të fizibilitetit, të realizuara nga kompania jonë janë:

Në vitin 1994, kompania jonë ka realizuar projektin e saj të parë me modelin BOT (ndërtim-operim-transferim). KISIK HEC me kapacitet fuqie të instaluar 9.6 MW, e ndërtuar në provincën administrative Kahramanmaraş, në rajonin Tekir në fshatin Dongel, ka një prodhim prej 33 milion kWh në vit. Ky është projekti i parë që u transferua në shtet në vitin 2009 nëpërmjet modelit BOT, pas 15 viteve të operimit të suksesshëm.

Projekti i dytë me modelin ndërtim-operim-transferim, CAMLICA I HEC, u vendos në operim në 1998. Camlica

I HEC e vendosur në provincën administrative Kayseri, në rajonin Yahyalı, në fshatin Camlica, ka një kapacitet fuqie të instaluar prej 5.4 MW dhe prodhim vjetor 29 milion kWh. Ne e transferuam këtë projekt në shtet në 2013 nëpërmjet modelit BOT, pas 15 vitesh operimi të suksesshëm.

Gjithashtu HEC AYEN-OSTIM që operon me gaz natyror me cikël të kombinuar me fuqi të instaluar 41 MW, e ndërtuar nga një nga filialet tona, AYEN OSTIM ENERGY PRODUCTION A.S. në Zonën Industriale të Organizuar në Ankara, Ostim, u vendos në operim në gjysmën e dytë të 2004. Prodhimi vjetor i impiantit është 280 milion kWh.

Ndërkohë, një nga filialet tona KAYSERİ ELECTRICITY PRODUCTION INDUSTRY AND TRADE A nëpërmjet modelit Ndërtim- Operim- Transferim (BOT), ka ndërtuar HEC dhe digën YAMULA me fuqi të instaluar 100 MW, një investim i vënë në operim më 30.07.2005. Kapaciteti vjetor i prodhimit i impiantit është 423 milion kWh.

Përsa i përket parqeve eolike, në vitin 2009 kompania jonë ka realizuar projektin e saj të parë me erë të emërtuar AKBUK WIND ENERGY POWER PLANT, e cila ka një kapacitet të instaluar 31.5 MW dhe prodhim vjetor 122.5 milion kWh. Ky central është vendosur në

provincën administrative Aydin, në rajonin Akbuk.

Projekti BUYUKDUZ HEC është futur në operim në 2012. Ky central është vendosur në provincën administrative Gumushane, në rajonin Kurtun, ka kapacitet fuqie të instaluar 70.8 MW dhe prodhim vjetor 192 milion kWh.

Një nga filialet tona AKSU CLEAN ENERGY ELECTRICITY PRODUCTION INDUSTRY AND TRADE A.S ka ndërtuar PARKUN EOLIK AKSU me fuqi të instaluar 72 MW, investim i cili është vënë në operim në 2012. Kapaciteti i prodhimit vjetor të centralit është 237 milion kWh.

Një ndër projektet tona me erë të licensuara nga EMRA për 49 vjet është PARKU EOLIK MORDOGAN, i cili ka kapacitet të instaluar 31.5 MW dhe kapacitet prodhimi vjetor të impjantit 99.4 kWh. Ky central me vendndodhje në Izmir, Mordogan është futur në prodhim në vitin 2013.

PARKU EOLIK KORKMAZ është vendosur në Izmir, Seferi- hisar. Ky central i cili ka filluar prodhimin në vitin 2014, ka një kapacitet të instaluar prej 24 MW dhe prodhim vjetor 83 milion kWh.

PARKU EOLIK AKBUK II ka kapacitet të instaluar 20 MW dhe prodhim vjetor 68 milion kWh. Ky central është vendosur në Aydin, Akbuk dhe është futur në prodhim në 2016. Përsa i perket PARKUT EOLIK CAYPINAR (24MW; 73,6 milion kWh/vit), licensa paraprake është marrë nga EMRA dhe punimet do të nisin së shpejti.

të vitit 2017 është finalizuar Projekti i "HEC-ve mbi Pellgun e Lumit Fan".

"Investimi ynë aktual ka arritur në vlerën e investimit prej 248 milion euro me 109.72 MW fuqi të instaluar dhe 348 milion kWh prodhim energjie për vit. Projekti ka 23 km tunele energjie, i cili është një shembull unik në Shqipëri." Z. Fahrettin shpjegon se Shqipëria është si një shtëpi e dytë për ata, ku kultura e njëjtë, historia e përbashkët dhe burimet natyrore të pasura tërhoqën vëmendjen e tyre. "Stabiliteti politik dhe procedurat e lehtësuara janë mbështetje për interes të biznesit tonë." u shpreh Z. Fahrettin. Ayen Energji ka fituar tenderin HEC Kalivac sipas ofertës tenderuese me 111 MW kapacitet të instaluar dhe 366 milion kWh prodhim energjie, investim mbi lumin Vjosë. "Me këtë projekt kompania jonë do të jetë prodhuesi më i madh i energjisë në Shqipëri", thekson Drejtori. Kompania aktualisht tregton produktin e saj në 7 vende të ndryshme në tregun e energjisë në zonën e Ballkanit. "Me rregulloret e reja mbështetëse, ne do të kemi më shumë interes në prodhimin e fuqisë së erës", shton Z. Arman. Me lëvizjet e duhura Shqipëria ka fuqinë të kompensojë konsumatorët e saj dhe do të jetë e pavarur në tregun e energjisë elektrike, e cila është shumë e rëndësishme për brezat e ardhshëm.

Për momentin, me fuqi totale të instaluar dhe licensuar prej 514,85 MW dhe 2094 milion kWh kapacitet prodhimi vjetor, Ayen Energy A.S është një



Për më tepër, filiali ynë AYEN ELECTRICITY TRADE A.S ka marrë licencë të shitjes me shumicë të energjisë elektrike dhe është aktiv në treg me blerje dhe shitje të energjisë elektrike.

TREGU SHQIPTAR

Kompania ka hyrë në tregun Shqiptar në vitin 2010. Me marrëveshjen e koncesionit që është nënshkruar në Maj 2011 posedon koncesionin si investim i dytë më i madh i energjisë në Shqipëri. Drejtori i Përgjithshëm dhe CEO i kompanisë Z. Fahrettin Amir Arman shpjegon se në Dhjetor



ndër kompanitë lider të sektorit të energjisë në Turqi. "Kompania jonë në vazhdimësi është duke studiuar dhe përgatitur studime fizibiliteti me qëllim ndërtimin e impianteve të reja hidroelektrike, parqe eolike dhe termale."

Fahrettin Arman
Drejtor i Përgjithshëm
i Grupit "AYEN ENERGY"



POLITIKA PROTEKSIONISTE: INDUSTRIA E ÇELIKUT NË SHETETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Presidenti i SHBA'së Donald Trump, në 5 mars bëri të ditur vendimin e tij lidhur me vendosjen e një tarife prej 25 për qind mbi çelikun e importuar dhe një tarifë prej 10 për qind mbi aluminin e importuar. Partnerët kryesorë tregtarë të Shteteve të Bashkuara reagojnë me zemërim kundrejt tarifave të vendosura nga Presidenti Donald Trump i cili synonte mbrojtjen e prodhuesve vendas.

Ndërkohë që Shtetet e Bashkuara, importuan rreth 36 milion ton çelik në vitin 2017 me Kanadanë, Brazilin dhe Korenë e Jugut si furnizues kryesorë, kjo shifër përbënte më pak se 8 % të volumit të tregtisë të çelikut prej 473 milion tonësh në vit. Gjithashtu, ndërkohë që tarifatat do i vendosnin çmime disa importeve jashtë tregut të SHBA'së, analistët dhe konsulentët e Wood Mackenzie vlerësojnë se 18 milion ton do të devijojnë në tregje të tjera, ose më pak se 4 % të volumeve vjetore të tregtimit.

Industrialistët në SHBA pohojnë se vendimi do të krijojë më shumë vende pune brenda vendit dhe punonjësit do të jenë më mirë për shkak të tarifave të mbrojtura. U.S. Steel njoftoi se do të punësonte 500 punonjës për të rifilluar operacionet në një kompani që ishte mbyllur më herët në Illinois. Vendimi i kompanisë u bë i mundur falë tarifave të vendosura nga Presidenti Trump dhe ajo u shpreh se "Lidershipi i presidentit është i nevojshëm për të filluar prodhimin, kështu që kompanitë tona mund të konkurrojnë, të fitojnë dhe të krijojnë vende pune që mbështesin punonjësit tanë dhe komunitetet në të cilat operojmë. (Reuters, Maytaal Angel. March 8)".

Por disa ekonomistë shprehen se veprimi tregtar do t'i kushtojë

ekonomisë mijëra vende pune. Disa nga analizat vijnë nga vetë industria e aluminit. Instituti Amerikan për Çelikun Ndërkombëtar, një grup advokues pro-tregtisë, citon se rreth 142,000 amerikanë punojnë në industrinë e çelikut. Por Instituti shprehet se rreth 6.5 milionë amerikanë janë të punësuar nga kompanitë që përdorin çelik. Disa nga këto profesione do të jenë në rrezik për shkak të rritjes që pritet në produktet e çelikut dhe aluminit.

Edhe pse tregtia e lire është e rëndësishme për marëdhëniet ekonomike ndërkombëtare dhe marrëveshjet që rregullojnë tregjet ndërkombëtare, shtete të caktuara mund të aplikojnë politika mbrojtëse nëse gjykojnë se industritë e brëndshme rrezikohen nga konkurrenca e importeve. Në disa raste, kompanitë që operojnë në shtete të sapo industrializuara eksportojnë mallrat e tyre me një çmim shumë më të ulët se çmimi i tyre konkurrenues brenda vendit ose vlera normale e prodhimit duke shkaktuar atë që njihet si "çmimi dumping".

Sipas rregullores së Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), autoritetet mund të vendosin një taksë balancuese për të mbrojtur një industri të caktuar nga konkurrenca e padrejtë për një periudhë kohore,

nëse një kompani ose shumica e një sektori industrial deklarojnë se dëmtohen për shkak të importit me çmime dumping. Në raste të tilla, një kompani ose një grup kompanish, përgatit dhe dorëzon një dosje tek autoriteti kompetent në përputhje me rregulloren e brendshme, dhe autoritetet vlerësojnë nëse duhet vendosur një taksë anti-dumping apo jo.

Neni 6 i Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë nënvizon se: "1. Palët kontraktuese konstatojnë se egziston fenomeni dumping, me të cilin kuptohet se produktet e njërit vend po tregtohen në një vend tjetër nën çmim normal, duhet të dënohet nëse shkakton rrezik për dëme materiale në një kompani të palës kontraktuese në vend, ose edhe në rastet kur ndikon në zhvillimin e ngadaltë të industrisë vendase" në mënyrë që të mbrohet industria e brendshme, Artikulli 2 vijon "2. Në mënyrë që të parandalohen çmimet "dumping", një palë kontraktuese mund të tërheqë për çdo produkt të hedhur një taksë anti-dumping jo më të madhe se sa diferenca që shkakton "dumping" për këtë produkt. Për qëllime të këtij neni, kufiri i dumpingut është dallimi i çmimit i përcaktuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1.



Importi i hekurit dhe çelikut amerikan ('000 Dollar)

Eksportuesit	2016	2017
Kanada	4,235,059	5,289,094
Brazil	2,185,394	2,951,927
Rusi	1,380,238	2,673,163
Meksika	1,480,131	1,791,615
Korea	1,832,926	1,406,038
Japoni	1,309,861	1,349,626
Gjermani	1,107,745	1,270,059
Turqi	941,358	1,111,928
Kina	873,462	1,030,852
Bota	22,461,623	28,842,365

Burimi: Trademap

Nismat anti dumping: sipas shteteve raportuese 01/01/1995 - 31/12/2016

India	839
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	606
Bashkimi European	493
Argjentina	348
Brazil	403
Australi	316
Kina	234
Afrika e Jugut	229
Turqi	213
Total	5286

Burimi: OBT

Sipas Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), një total prej 5,000 masash balancuese janë vendosur nga 105 vende të ndryshme që prej vitit 1995. Ndërkohë që India mban vendin e parë si shteti që mbron më së tepërmi industrinë vendase, SHBA'ja dhe Bashkimi Evropian zënë vendin e dytë dhe të tretë përse i përket proteksionizmit. Shqipëria e cila ka vetëm disa kompani të prodhimit dhe dëshiron që të rrisë prodhimin e brendshëm, kurrë nuk ka aplikuar masa balancuese për të mbrojtur industrinë e saj ekzistuese.

Erinda Zhupani
Sekretare e Përgjithshme, ATTSO

INSTITUTI YUNUS EMRE NË TIRANË ZËRI I GJUHËS TURKE

Fondacioni "Junus Emre" (Yunus Emre) është një fondacion publik i krijuar me Ligjin Nr.5653 dhe datë 05.05.2007 me qëllim prezantimin e Turqisë, të gjuhës

turke, të historisë, kulturës dhe artit turk; në lidhje me këtë të ofrojë në dobi të botës informacione dhe dokumente; të ofrojë shërbime jashtë shtetit për ata që duan të mësojnë gjuhën turke apo të njihen me kulturën dhe artin turk; të zhvillojë miqësinë e Turqisë me vendet e tjera duke shtuar shkëmbimet kulturore.

Kurse Instituti "Junus Emre" është një institucion që funksionon në varësi të Fondacionit me të njëjtin emër dhe me synimin për të realizuar qëllimet e Ligjit krahas mësimdhënies së turqishtes për të huajt në qendrat e ngritura jashtë vendit kryen aktivitete kulturore dhe artistike që synojnë prezantimin e vendit jashtë si dhe mbështet punimet shkencore.

Instituti "Junus Emre" aktivitetin e ka nisur në vitin 2009 dhe sot numëron më shumë se 40 qendra që veprojnë jashtë Turqisë. Krahas mëimit të gjuhës turke, këto qendra kulturore mbështesin edhe degët e Turkologjisë dhe mësimdhënien e turqishtes nëpërmjet bashkëpunimit që këto qendra bëjnë me institucionet arsimore në vende të ndryshme. Me ndërmjetësimin e Qendrave Kulturore organizohen shumë aktivitete për promovimin e kulturës dhe artit tonë. Gjithashtu këto qendra përfaqësojnë vendin në aktivitete të ndryshme që mbahen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.





Ne besuam tek e ardhmja e Shqipërisë.

Besoni dhe ju!



GRUPI AKSOY

Kompania "Aksoy Group" është ndërtuar si një biznes familjar duke u shtrirë në disa shtete dhe duke operuar në fusha të ndryshme ekonomike që prej vitit 1969. Në vitin 2001, familja vendosi të bashkojë të gjitha kompanitë e saj aktive nën ombrellën e grupit "Aksoy Group". Grupi, si një biznesnë pronësi familjare, ka ofruar mundësi punësimi në shtete të ndryshme duke ndihmuar në ecurinë e ekonomive të vendeve respektive.

Që prej fillimeve të saj, Aksoy Group është një kompani me përgjegjësi shoqërore dhe luan një rol kyç në zhvillimin e shoqërisë. Sot, grupi vazhdon të operojë me të njëjtat standarde të larta etike dhe sociale. Në vitin 2004, përveç aktiviteteve tregtare, Aksoy Group ka filluar të investojë në sektorë të rinj, si ushqimi, shëndetësia, ndërtimi, energjia dhe minierat.

UNIVERSAL FOOD

Fabrika e miellit në Fushë Kosovë është privatizuar në vitin 2007 nga një nga kompanitë e Aksoy Group. Modernizimi i objektit u përfundua në Nëntor 2009, fabrika ka kapacitet mulliri prej 500 tonë në ditë dhe punon me sistemin e kontrolluar kompjuterik me automatizim të plotë.

Fabrika kryesore është në Fushë Kosovë vetëm 8 km larg nga kryeqyteti i Prishtinës. Sipërfaqja e përgjithshme është 43.869m² dhe ka

sipërfaqe të mbyllur prej 30.000m².

PINO TRADE

Aktiviteti I Aksoy Group në Ballkan filloi në vitin 1992 me themelimin e kompanisë Pino Trade në Shqipëri. Falë formimit të një rrjeti të suksesshëm ndërkombëtar, mentalitetit dhe profesionalizmit në punë, kompania arriti të veprojë me besim në tregun shqiptar dhe të jetë lider në fushën ku operon.

ALBMINES INVESTMENT GROUP

Alb-mines Investment Shpk. është themeluar në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë, në vitin 2001. Veprimtaria kryesore e kësaj kompanie është importi dhe shitja i produkteve ushqimore në Ballkan. Në vitin 2004, filloi aktivitetin në prodhimin e miellit të grurit falë fabrikës në Vorë/Tiranë.



INFORMACION PANAIRESH

KALENDARI I PANAIREVE DHE EKSPOZITAVE TREGTARE PËR VITIN 2018 / SHQIPERI

Nr.	ORGANIZATORI	TITULLI I PANAIRIT, EKSPOZITËS	DATA	VENDI
1	SHOQATA E BOTUESVE SHQIPTARE	<i>Panairi i Librit "Tirana 2018"</i>	14-18 Nëntor 2018	Pallati i Kongreseve
2	KLIK EKSPLO GROUP	<i>Panairi Nderkombetar i Tiranes –edicioni i 25-te</i>	21-24 Nëntor 2018	Pallati i Kongreseve

PANAIRET QË DO TË ORGANIZOHEN NË TURQI GJATË VITIT 2018

Panairi	Qyteti	Data	Sektori	Pjesëmarrja
HEFI –Panairi i HEFI Panairi i elektroshtëpiakeve dhe teknologjisë mbështetëse.	Stamboll	20-23 Qershor	Elektro-shtëpiake	Vetëm kompani
Samsun 2018 - Panairi i 4. i Bujqësisë, Blegtorisë dhe Teknologjisë Mbështetëse	Samsun	26-30 Shtator	Bujqësi	Kompani, shoqata, dhe institucione
Panairi Euroaziatik MAKTEK 2018	Stamboll	2-7 Tetor	Industria e Makinerive, industria e mbrojtjes dhe avionit, ndustria elektrike etj.	Vetëm kompani
Panairi i Mobilierisë Cukurova 2018	Adana	2-7 Tetor	Mobileri	Vetëm kompani
YAPEX 2018 – Panairi i 26. Nderkombëtar i Materialeve dhe Teknologjisë së Ndërtimit	Antalja	14-17 Nëntor	Materiale dhe teknologji ndërtimi	Vetëm kompani
Samsun Panairi i 3. i Ushqimit dhe Teknologjia e Përpunimit të Ushqimeve, Panairi i Paketimit	Samsun	22-25 Nëntor	Produktet ushqimore dhe pije	Vetëm kompani

AlbElite
design and photography studio

PARTNER NË DIZENJIMIN DHE ZHVILLIMIN E FAQEVE TË INTERNETIT

info@albelite.net
www.albelite.net



ATTSO : NJË URË LIDHËSE NDËRMJET SHQIPËRISË DHE TURQISË

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqiptari- Turqi (ATTSO) ushtron aktivitetin e saj si organizatë jo - fitimprurëse e biznesmenëve profesionistë nga Turqia dhe Shqipëria. Dhoma ka si qëllim që në bashkëpunim të plotë me Qeveritë përkatëse, të ngrejë në nivele më të larta marrëdhëniet ekonomike, tregtare, sociale dhe kulturore të dy vendeve tona mike.

Që prej themelimit të saj në dhjetor 2014, Dhoma ka punuar për të rritur tregtinë midis Turqisë dhe Shqipërisë dhe për të promovuar investimet e huaja në Shqipëri. ATTSO është duke u rritur çdo vit e më shumë, tashmë ajo numëron më shumë se 50 anëtarë që përfaqësojnë biznesin e madh, të mesëm dhe të vogël dhe që operojnë në sektorë e fusha të ndryshme të ekonomisë.





1. MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME MÛSIAD BALLKAN

ATTSO nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me MÛSIAD Ballkan. Marrëveshja u nënshkrua midis Kryetarit të Bordit të ATTSO's Z. Seyhan Pencabligil dhe Kryetarit të MÛsiad Ballkan Z. Bilal Kara. Gjatë ceremonisë ishte i pranishëm edhe Ambasadori i Republikës së Turqisë Z. Murat Ahmet Yörük. Ky bashkëpunim do të kontribuojë në intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike jo vetëm midis Shqipërisë dhe Turqisë por edhe në rajon.



2. MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN E TIRANËS, FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA

Në 8 Mars 2018, u firmos marrëveshja e bashkëpunimit midis Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi dhe Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Dega Turqisht. Marrëveshja u firmos nga Sekretarja e Përgjithshme e Dhomës Znj. Erinda ZHUPANI dhe Dekanin të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja Z. Artur SULA.

Kjo marrëveshje do të mbështesë studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Degës së Turqishtes jo vetëm në trajnime dhe gjatë periudhës së stazhit, por do të ndihmojë edhe në punësimin e tyre duke i ofruar

mundësi për të zhvilluar aftësi të reja.



3. ANËTARË TË ATTSO'S TAKOHEN ME Z. CENAP AŞCI

Në datën 16 Shkurt 2018 në kuadër të takimit të Komitetit të Përbashkët Turqi-Shqipëri për Doganat, në Tiranë është mbajtur një takim pune mes Kryesekretarit të Ministrisë së Doganave dhe Tregtisë të Republikës së Turqisë, Z. Cenap Aşçı dhe kompanive anëtare të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri - Turqi.

Gjatë këtij takimi, anëtarët e ATTSO's patën mundësinë të ndajnë me Z. Cenap Aşçı disa nga problematikat që kompanitë e tyre hasin në doganat shqiptare dhe ato turke.



4. TAKIM ME ZV. DREJTORESHËN E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Në datë 06.03.2018, u zhvillua një takim midis anëtarëve të ATTSO's dhe Zv.Drejtoreshës së Përgjithshme të Administratës Doganore Shqiptare Znj.Mirela Meko së bashku me ekipin

mbështetës. Në takim, u diskutuan problemet që hasin kompanitë anëtare të ATTSO's në institucionet doganore shqiptare. Gjatë këtij takimi, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për tu gjetur zgjidhje problematikave që u diskutuan.



5. ANËTARËT E BORDIT TË ATTSO'S TAKOHEN ME MINISTREN E SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES ZNJ.SONILA QATO

Nën kujdesin e veçantë të Ambasadorit të Turqisë në Tiranë Shkëlqesisë së Tij Z. M.Ahmet Yörük, në kuadër të procesit të nisur të konsultimeve dhe dëgjësave publike me sipërmarrjen në vend, në ambientet e Ambasadës Turke u organizua një takim pune midis Anëtarëve të Bordit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri - Turqi (ATTSO) dhe Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Znj.Sonila Qato.

Takimi pati në fokus politikat e sipërmarrjes, projektet e ardhshme si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Sipërmarrjes dhe anëtarëve të ATTSO's për krijimin e një klime sa më të mirë biznesi në Shqipëri.



TAKIMI MES ANËTARËVE TË ATTSO'S



Në datën 20 Mars 2018 u organizua mbledhja e rradhës së anëtarëve të bordit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi. Kësaj here mbledhja u organizua në ambientet e Institutit Yunus Emre, dhe të pranishëm ishin Ambasadori i Republikës së Turqisë njëkohësisht edhe Kryetar Nderi i Dhomës Z. M. Ahmet Yörük si dhe drejtori i Institutit Yunus Emre në Tiranë Z. Ömer Demirbaş.

Pas mbledhjes, u organizua një pritje tradicionale Turke me të

gjithë anëtarët e Dhomës, ku secili prej tyre bëri një prezantim të shkurtër rreth aktiviteteve të kompanive që ata përfaqësojnë.

Ambasadori Z. M. Ahmet Yörük falenderoi kompanitë pjesëmarrëse dhe theksoi se ATTSO do të kontribuojë akoma më shumë në rritjen dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve tona. Ai u shpreh se vlëra e investimeve turke këtu në Shqipëri, përfshirë edhe ato në infrastrukturë është aktualisht rreth 2.7 miliardë dollar, por ne kërkojmë që këto investime të rriten në numra dyshifrorë. Gjithashtu shtoi se Dhoma duhet të kthehet në një qendër tërheqëse për të gjitha kompanitë, pasi kjo do të ndikonte në krijimin e një sinergjie koordinuese dhe bashkëpunuese midis anëtarëve të saj.



Ndërkohë, Kryetari i ATTSO, Z. Seyhan Pencaplıgil u ndal tek roli i Dhomës dhe u shpreh se Dhoma do të vazhdojë të qëndrojë një institucion në mbështetje të interesave të anëtarëve dhe bashkëpunimi midis tyre do të ndihmonte në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Turqisë dhe Shqipërisë. Ai gjeti rastin të falenderonte të gjitha kompanitë anëtare, veçanërisht ato shqiptare për kontributin që i kanë dhënë Dhomës.

"Jeta juaj
do të jetë më e bukur"



Seritë e Ephesus marrin inspirim nga Ephesus, qyteti i parë i përbërë nga mermeri i cili përshatet me lehtësi në të gjitha hapësirat. Kjo seri, e cila vjen me dimensione të ndryshme, do të jetë thelbësore për hapësirat tuaja moderne.

60x120 – 120x120 // Efekti i Mermerit

 **seramiksan**
seramiksan.com.tr

- FORM -
i n t e r n a t i o n a l



PRITJA E ORGANIZUAR ME RASTIN E TAKIMIT TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË DHOMËS SË TREGTISË DHE INDUSTRIË SHQIPËRI -TURQI

Në datën 10 Maj 2018 u organizua një pritje me rastin e Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri – Turqi. 2018. Me qëllim rritjen e komunikimit midis anëtarëve, njihjen me projektet dhe qëllimet e Dhomës. Mbledhja, e cila synonte jo vetëm bashkëpunimin midis anëtarëve por dhe ndërgjegjësimin e të punuarit së bashku u organizua në ambientet e Mak Albania Hotel & Tower.

Pas mbledhjes, u organizua një pritje ku të pranishëm ishin kompanitë anëtare të Dhomës, Kryeministri i Shqipërisë Z. Edi Rama, Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë Z. M. Ahmet Yörük, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Znj. Sonila Qato, përfaqësues nga shoqatat e biznesit dhe dhomave bilaterale, përfaqësues nga media, miq dhe partnerë të tjerë të dhomës. Në të njëjtën kohë u bë edhe prezantimi i tre kompanive më të reja si anëtarë bordi dhe anëtarë të asociuar i kompanive Sigal Uniq Group Austria, Kastrati Grup dhe Tashko-Pustina.





Kryetari i ATTSO, Z. Seyhan Pencapligil në fjalën e tij të mirëseardhjes shprehu kënaqësinë për faktin që ATTSO nga momenti i themelimit të saj në vitin 2014 ka zgjeruar dhe diversifikuar aktivitetin e saj duke u kthyer në një instrument të rëndësishëm të forcimit të bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve mike siç janë Shqipëria dhe Turqia. Ai shprehu besimin e tij personal në fuqinë e bashkimit të kompanive rreth të njëjtit qëllim të përbashkët për krijimin e një mjedisi pune proaktiv, stimulues dhe tërheqës. Duke shprehur dëshirën që më shumë kompani shqiptare të bëhen pjesë e ATTSO, Z. Pencapligil theksoi se prania e kompanive shqiptare do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve mes dy vendeve.

Duke nënvizuar lidhjet historike

dhe miqësinë që ekzistojnë mes dy vendeve, ambasadori turk në Tiranë, Z.Yörük u shpreh se të ardhmen e tyre të përbashkët Shqipëria dhe Turqia duhet ta ndërtojnë pikërisht bazuar në këto baza të shëndosha. "2,7 miliardë dollarë është shifra e investimeve turke në Shqipëri dhe shumë shpejt synojmë të kemi një rritje dyshifrore të këtyre investimeve. Vëllimi tregtar kap shifrën e 500 milionë dollarëve. Bashkëpunimi mes dy drejtuesve të shteteve tona u ka hapur horizonte të reja bashkëpunimit të kompanive private," u shpreh ambasadori duke iu referuar Kryeministrit Edi Rama dhe Presidentit Erdoğan. Sipas ambasadorit, ATTSO është kthyer në një levë të rëndësishme për avancimin e marrëdhënieve tregtare mes dy vendeve, ndërsa shtoi se synimi është që shumë shpejt numri i anëtarëve të Dhomës të arrijë në 100.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryeministri Rama theksoi se 3 vite e gjysëm pas themelimit të saj ATTSO është shndërruar në një instrument të rëndësishëm që rrit peshën përmbajtësore të bashkëpunimit ekonomik. "Ndaj bindjen se edhe pse në këto vite është bërë progres në rritjen e stokut të investimeve dhe fluksit të investimeve direkte, përsëri ne mund të bëjmë më shumë. Vëllimi tregtar u rrit me 10% gjatë vitit të kaluar, por shifra është shumë e vogël për potencialin jashtëzakonisht të madh dhe që ne duhet ta transformojmë në një realitet të qënësishëm," tha Rama.

Eventi u shoqërua me performancën muzikore me motive ballkanike të artistit dhe akademikut Evrim KAŞIKÇI dhe ekibit të tij i cili erdhi enkas nga qyteti Edirne i Turqisë.



KONCERTI I ORKESTRËS SIMFONIKE TË FËMIJËVE

Koncerti i orkestrës simfonike të fëmijëve "DY DUAR KANË NJË ZË" u organizua me rastin e ditës së Sovranitetit Ndërkombëtar dhe Festës së Fëmijëve më 23 Prill 2018, tek Pallati i Kongreseve.

Ky koncert u organizua nga Ambasada e Republikës së Turqisë në Tiranë në bashkëpunim me Institutin Junus Emre. Në fund të koncertit Kryetari i Bordit të ATTSO's Z.Seyhan Pencablilgil në emër të ATTSO's iu shpërndau çanta fëmijëve pjesëmarrës në Koncert.



ATTSO - DARKA E IFTARIT

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri – Turqi (ATTSO), me sponsorizimin e kompanisë Anëtare të Bordit Drejtues Ayen Energy, organizoi për anëtarët e saj Darkën e Iftarit me rastin e muajit të Ramazanit.

Në Iftarin e organizuar morën pjesë Ambasadori i Republikës së Turqisë Z. M. Ahmet Yörük, delegacioni nga Turqia; Kryetari i Bordit Themelues i Fondacionit Maarif Turqi, Zv. Këshilltari i Ministrisë së Arsimit të Republikës Turke, Kryetari i sindikatave Egitim-Bir-Sen dhe Memur-Sen, të ftuar të shoqatës Musiad Ballkan nga Maqedonia, përfaqësues të institucioneve turke dhe shqiptare si dhe anëtarët e Dhomës.

Gjatë fjalës së tij Kryetari i Bordit Drejtues Z. Seyhan Pencablilgil falenderoi të gjithë anëtarët që kontribuojnë në jetën e Dhomës, ashtu sikur në këtë rast kompaninë Ayen Enerji. Duke qenë se tryezat e Ramazanit janë tryeza bereqeti, ai shprehu dëshirën që bisedat e kësaj darke të krijojnë mundësi të reja biznesi.



ATTSO AKADEMI

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri – Turqi dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në datë 1 Qershor, në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja sala "Evropa", nga Kompania Anëtare e Bordit Drejtues të ATTSO, ALBtelecom Sh.A. u prezantua tema "Siguria e Informacionit përfshirë edhe rastin e ALBtelecom".

Pjesë e panelit ishte Dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Zv. Dekani, Sekretarja e Përgjithshme e ATTSO's si dhe përfaqësues së kompanisë ALBtelecom. Gjatë fjalës së saj Sekretarja e Përgjithshme e ATTSO's Znj. Zhupani u shpreh se ky aktivitet është fillimi i një sërë aktiviteteve që do të realizohen nën siglën "ATTSO AKADEMI", ku kompanitë atëtare të Dhomës do të japin trajnime dhe seminare për fusha të ndryshme që prekin përditshmërinë e studentëve.

Studentët u informuan rreth sigurisë në internet, krimit kibernetik.

AGJENCIA TURKE PËR BASHKËPUNIM DHE KOORDINIM (TİKA)

Agjencia Turke për Bashkepunim dhe Koordinim (TİKA) ka 61 zyra koordinimi në 59 vende të ndryshme të botës.

TİKA që në vitin 1992 operon në Shqipëri, ndërkohë që zyrtarisht zyra e koordinimit në Tiranë është hapur në vitin 1996. Pra, prej më shumë se 20 vite TİKA kontribuon me projektet dhe ndihmën e saj në zhvillim dhe ngritje kapacitetesh në Shqipëri.

Sektorët ku TİKA kryesisht ka ndihmuar dhe vazhdon të ndihmojë me projekte dhe programe janë sektorët ekonomik, tregtar, teknik, projekte sociale dhe kulturore. TİKA është e gatshme për të financuar në çdo sektor ku ka nevojë për mbështetje shteti shqiptar, dhe në Shqipëri një rëndësi e veçantë i është dhënë shëndetësisë, arsimit, turizmit, bujqësisë, blegtorisë etj. Prioritete këto të cilat janë të theksuara nga Qeveria Shqiptare.

Me fondet e TİKA-s në Shqipëri janë rehabilituar kopshte e shkolla, ujësjellësa, janë siguruar aparatura moderne për shumë spitale, janë trajnuar mjekë, por edhe punonjës të policisë. Ndihma e TİKA-s është shtrirë në turizëm, kulturë, media etj.

TİKA renditet si një nga donatorët kryesorë që ka ndikuar në zhvillimin e Shqipërisë dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve shqiptarë, në dy dekadat e fundit.

Deri në ditët e sotme nga TİKA në Shqipëri janë realizuar rreth 437 projekte të sektorëve të lartpërmendur.



Fmt Group u themelua për herë të parë në Turqi si prodhues stabilizatorësh tensioni. E motivuar nga eksperiencia e frytshme në treg kompania u zgjerua duke hapur degën e saj të parë në Shqipëri në vitin 2003. Progresi dhe rritja e kërkesave në mënyrë të vazhdueshme nxiti kompaninë që në vitin 2008 të hapte filialin e saj në Kosovë. E motivuar nga përshtypjet pozitive të klientëve Fmt Group u zgjerua duke hapur dhe një degë të vetën në Malin e Zi, në vitin 2010. Me modesti sot mund të pranojmë se Fmt Group është e vetmja kompani prodhuese për moto-gjeneratorë jo vetëm në Shqipëri por në gjithë rajonin e Ballkanit. Gjithashtu e vetmja e specializuar në sinkronizimin e gjeneratorëve të fuqive të ndryshme. Duke qenë në shërbim të tregut dhe përmirësimit të vazhdueshëm të produktit Fmt Group ka filluar punën për ndërtimin e një fabrike të re, prej 14000 m², plotësisht sipas standarteve Europiane dhe me kapacitet prodhimi deri 3700kva. Në këtë rrugëtim të suksesshëm Fmt Group ka arritur të sigurojë bashkëpunimin dhe ekskluzivitetin me markat botërore të motorëve dhe alternatorëve si Volvo / Perkins / Scania / FPT Iveco / Cummins / Doosan / Marelli / Stamford / Mecc Alte etj. Mbështetjen dhe rezultatet pozitive të punës së përditshme kompania ja dedikon edhe stafit të përkushtuar dhe profesional që ajo disponon. Inxhinierë me një eksperiencë 30 vjeçare dhe me prirje drejt zhvillimit, përmirësimit të cilësisë së produktit sipas standarteve botërore. Vizioni i kompanisë është të zgjerojë tregun në mbarë botën me produkt “Made in Albania”. Aktualisht ka arritur të eksportojë në 11 shtete të botës si: Kosovë, Mal të Zi, Greqi, Rumani, Kroaci, Angli, Portugali, Libi, Pakistan, Afrikë Qendrore, Beliz dhe së fundi në Tunizi. Tek Fmt Group mund të gjeni një produkt të çertifikuar sipas standarteve ISO 9001, ISO14001, OHSAS 18001, CE, staf të kualifikuar, shërbim mirëmbajtje 24 orë. Kënaqësia e klientit është motivimi i punës sonë.

Gama e produkteve që kompania Fmt Group ofron është:

- Moto-Gjeneratorë 1-3700 kVA
- Stabilizatorë Tensioni 2-3500 kVA
- UPS 1-6400 kVA
- Transformatorë të tensionit të lartë
- Produkte Led
- Solar
- Pjesë këmbimi
- Filtra, Lubrifikante

Zgjedhja jemi ne!



Kompania **FMT GROUP** me nje eksperience 27 vjecare ne tregun e gjeneratoreve ofron markat me te mira si: IVECO / VOLVO / SCANIA / PERKINS / CUMMINS / DOOSAN me alternatore MARELLI / MECC ALTE / STAMFORD dhe me cmimet me konkuruese ne treg.

FMT GROUP eshte dizenjuesi dhe prodhuesi i gjeneratoreve Fmt. Ne ofrojme kapacitetet nga 1-3700 kVA, sipas kerkesave automatik, manual, te sinkronizuar, te hapur, njefazor dhe trefazor.

FMT GROUP eksporton ne Europe dhe ne mbare boten.

because we have the power

27 VITE
EKSPERIENCE



GJENERATORE



NJEFAZOR

TREFAZOR

Kapaciteti i energjise se prodhuar per njesi

1-25000 kVA

Gjeneratore me nafte

Gjeneratore me gaz

Gjeneratore industrial

Gjeneratore njesi industriale

Gjeneratore te sinkronizuar

POWER GENERATION

WE HAVE THE POWER.

PER ME SHUME NA KONTAKTONI NE:

AUTOSTRADA TIRANE-DURRES, KM2, MEZEZ-KASHAR, TIRANA-ALBANIA
MOB: +355 69 20 64 458, +355 69 40 09 193, +355 69 70 57 620

info@fmtgroup.al | www.fmtgenerator.com | www.fmtgroup.al

BOGA & ASSOCIATES

Boga & Associates u krijua në vitin 1994 si një nga zyrat e para ligjore në Shqipëri, duke fituar reputacion falë ofrimit cilësor të shërbimeve ligjore, fiskale dhe kontabël ndaj klientëve të saj, si në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë (Prishtinë).

Cilësia e lartë në ofrimin e shërbimeve është arritur nëpërmjet aftësive dhe vendosmërisë së një grupi profesionistësh, avokatë dhe ekonomistë, me eksperiencë në fusha të ndryshme. Zotërimi në mënyrë profesionale i shumë gjuhëve të huaja nga ana e stafit, ka ndihmuar klientelën tonë ndërkombëtare që të sigurojë akses të shpejtë në mjedisin tregtar shqiptar dhe atë kosovar.

Zyra ofron për klientët e saj të gjitha shërbimet ligjore, fiskale dhe kontabël të nevojshme për të themeluar dhe ushtruar aktivitetin tregtar në Shqipëri dhe Kosovë në shumicën e industrive kryesore, duke përfshirë bankat dhe institucionet financiare, si dhe kompani që operojnë në sigurime, ndërtim, energji, media, miniera, naftë dhe gaz, shërbime profesionale, pasuri të paluajtshme, teknologji telekomunikacioni, turizëm, transport, infrastrukturë dhe sektorë të produkteve të konsumit.

Gjatë këtyre viteve, zyra ka ofruar asistencë ligjore në fushën e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore, koncensionëve, transaksioneve me pasuri të paluajtshme, themelimit të shoqërive tregtare, në fushën e doganave si dhe në atë fiskale dhe të kontabilitetit, duke u orientuar vazhdimisht nga një ndjeshmëri e lartë për t'ju përshtatur zhvillimeve në mjedisin e biznesit shqiptar.

BOGA & ASSOCIATES 20
LEGAL • TAX • ACCOUNTING

BOGA & ASSOCIATES

LEGAL • TAX • ACCOUNTING

GJINISHI TAX CONSULTING

Kompania jonë është themeluar ne vitin 2011 nga nje staf i ri dhe energjik i cili vijen sot me një eksperience 15-vjecare në këtë fushë.

Fuqia e grupit te punës qëndron pikërisht në efikasitetin dhe korrektesinë profesionale që tregohet nga secili prej nesh.

Kjo na bën që ta kemi më të lehtë të arrijmë filozofinë dhe objektivat tona.

Klient i kënaqur

Kjo është motoja jonë e cila na bën të ecim me hapa galopante në tregun e vogël shqiptar. Në pikësynimet tona nuk është materialiteti dhe vlera/madhësia e një kontrate. Për ne cdo klient, i cilit do statusi apo xhiroje qoftë, trajtohet po në të njëjtën mënyrë, me të njëjtën korrektësi e përkushtim.

Profesionalizēm

Korrektësia, praktikiteti dhe efikasiteti i shërbimit dhe i zgjidhjeve të menjëhershme që mund të na kërkohen nga klientët përbejnë profesionalizmin tonë. Privatësia e informacionit të cdo

klienti është përparësi për ne.

Efekti kohë është shumë i rëndësishëm si për kompanitë me të cilat bashkëpunojmë, ashtu edhe për retabilitetin tonë. Dhënia e shërbimeve në kohën e duhur dhe zgjidhja e problematikave të ndryshme brenda afateve të tyre, dhe padiskutim saktë, mbetet një nga pikat tona më të forta.

Akses

Shërbimet tona i ofrohen të gjithë bizneseve shqiptare por edhe atyre të huaja. Komunikimi në gjuhën amtare jep më tepër siguri dhe garanci për cilësinë e shërbimeve. Momentalisht japim shërbime në gjuhë angleze, italiane, turke.



ANËTARËT E BORDIT DREJTUES



A STAR ALLIANCE MEMBER

ANËTARËT E ASOCIUAR



ANËTARËT E DHOMËS

- | | | |
|---------------------------|--|----------------------------------|
| 01. ABC Detergjent | 16. Ernst&Young Albania | 31. Price Waterhouse Coopers |
| 02. Agna S.A. | 17. ESA | 32. Salillari shpk |
| 03. Alb-Star shpk | 18. IFIS | 33. Samuel International shpk |
| 04. Albania Leasing sh.a. | 19. Güven Hastanesi A.S. | 34. Smart Insurance Broker |
| 05. Albplast shpk | 20. Gjinishi Tax Consulting | 35. Softi shpk |
| 06. AMG shpk | 21. Henri 2000 shpk | 36. Studio Përmbartimore Shkrela |
| 07. Boga and Associates | 22. Hoxha Security | 37. Trium Communication |
| 08. Bosfor Group shpk | 23. Kılıç Aquaculture Albania | 38. Tukoal |
| 09. Breçani Security | 24. MAK Albania shpk | 39. Tur- Tekstil |
| 10. CC Law Office | 25. Medinistanbul shpk | 40. VAS Group |
| 11. Cotex Textile shpk | 26. Mega Holding Balkan | 41. XHEKO shpk |
| 12. Dental Turk -A | 27. Natyral Vita | |
| 13. Design Angel | 28. Nobel İlaç San. Ve Tic. Ş.A. | |
| 14. Dolsar Mühendislik | 29. Pentagene | |
| 15. Endrit Xhaferaj | 30. Pharmactive İlaç Sanayi ve Ticaret | |



**INVESTIM NË ENERGJINË E PASTËR
PËR TË ARDHMEN E SHQIPËRISË**



HEAD OF TRADING:
Kenan Karamehmedovic
Tel: 00355 44318448 - Fax: 00355 44510012
trading@ayen.com.tr - confirmations@ayen.com.tr

PRESS CONTACT:
Altin Kodra - Suzana Lami
Tel: 00355 44 510010/1 - Fax: 00355 44 510012
ayenas@ayen.com.tr